



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ae.nr.383/2019

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit [“V...”], me seli në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [A.K], avokat nga Prishtina, kundër të paditurve [“E...”] me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [E.A], avokat nga Prishtina, [“C...”], me seli në Fushe Kosove, dhe [“K...”] sh.a, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.470/2017, të datës 11.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2020, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHEN** ankesat e paditësi [“V...“], me seli në fshatin ..., dhe të paditurit [“E...“], me seli në Ferizaj, **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.470/2017, të datës 11.10.2019, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike EK.nr.470/2017, të datës 11.10.2019, ku në pikën I të dispozitivit të aktvendimit është aprovuar si e bazuar kërkesa e palës së parë të paditur [“E...“] me seli në Ferizaj, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 1,288.00€, ndërsa refuzohet si e pabazuar kërkesa në shumën prej 1,046.00€. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktvendimit ka aprovuar si të bazuar kërkesën e palës së dytë të paditur [“C...“], me seli në Fushe Kosove, lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 1,288.00€, ndërsa refuzohet si e pabazuar kërkesa në shumën prej 542,40€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor paditësi [“V...“], me seli në fshatin ..., ka paraqitur ankesë, duke e ankimuar vendimin e gjykatës së shkallës , duke theksuar së mbesim pran kërkesës që të aprovohet ankesa jonë dhe në do të kryejmë obligimin ligjore ndaj palëve, sepse në vet jem tërheq nga padia dhe kërkesëpadia.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjore ankese ka paraqitur edhe i autorizuari i të paditurit ["E..."] me seli në Ferizaj, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozimin që aktvendimin ankimor në al.I të dispozitivit – pjesën refuzuese që ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore për të paditurin ["E..."], në shumën prej 1,046.00€ të ndryshohet dhe detyrohet paditësi që të paditurit t'ia paguaj shumën prej 1,046.00€ si dhe shpenzimet e përpilimit të ankesës me taksa gjyqësore në shumën prej 187.00€.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:  
Ankesat janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ["V..."], me seli në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me datën 02.12.2015 për shpërblimin e dëmit, kundër të paditurve ["E..."] me seli në Ferizaj dhe ["C..."] sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit dhe të vërtetohet se të paditurit gabimisht kanë bërë instalimin e rrjetit elektrik dhe i kanë shkaktuar dëm paditësit në vlerën prej 13,174,67€. Paditësi me datën 08.05.2019 ka bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv.

Paditësi me parashtesës e datës 23.09.2019, të hartuar me shkrim nga i autorizuari i palës së paditëse e ka bërë tërheqjen e padisë ndaj të paditurave ["E..."] me seli në Ferizaj, ["C..."] me seli në Fushë Kosovë, dhe ["V..."] me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se të autorizuarit e palëve të paditura ["E..."] me seli në Ferizaj dhe ["C..."] sh.p.k me seli në Fushë Kosovë, përmes parashtresave të hartuara me shkrim të datës 07.10.2019, përkatësisht të datës 08.10.2019, pas pranimit të aktvendimit lidhur me tërheqjen e padisë, ku të njëjtit kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore të cilat konsistojnë në shpenzimet të cilat i referohen përfaqësimit në seancat e mbajtura gjyqësore, përgjigjet në padi si dhe parashtesës së hartuara me shkrim lidhur me kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, andaj ka aprovuar si të bazuar kërkesën e të paditurës ["E..."], lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 1,288.00€, dhe ka refuzuar kërkesën prej 1,046.00€. Ndërsa ka aprovuar si të bazuar kërkesën e palës së dytë ["C..."], lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 1,288.00€, kurse ka refuzuar si të pabazuar shumën prej 5,42.40€.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së, e vlerëson aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.1 dhe 182 par. 2 pika n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e aktgjykimit, nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare respektivisht arsyet e dhëna janë të paqarta, ekzistojnë

kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet e aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Në pikën I të dispozitivit të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka aprovuar shpenzimet e të paditurës së parë ["E..."], si dhe të palës së dytë ["C..."], lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, mirëpo nuk është e qartë se cilat shpenzime ka aprovuar, si dhe nuk është sqaruar së cila palë është detyruar për pagimin e shpenzimeve, pasi dispozitivi nuk përmban urdhër detyrues për asnjërën palë. Kjo formë e formulimit të dispozitivit pa urdhër detyrues dhe saktësim të palës, e bën dispozitivin të paqartë, të pakuptueshëm, kontradiktor me vetveten dhe të pa-ekzekutueshëm.

Aktvendimi i atakuar gjithashtu është marrë edhe më shkelje të dispozitës së nenit 160.4 të LPK-së, e cila thekson së arsyetimi duhet të përmbajë kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që së i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, e në rastin konkrete gjykata e shkallës së parë është njaftuar vetëm me theksimin se pjesa e aprovuar i referohet 4 seancave të mbajtura të llogaritura sipas tarifës së Odës së Avokatëve, pa sqaruar se si janë llogaritur shpenzimet e aprovuara dhe pa dhënë fare arsyetim se për pjesën tjetër të kërkesave lidhur me shpenzimet.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të prishet.

Në ri-procedurë gjykata e shkallës së parë duhet evituar shkeljet e theksuara më lartë, në atë mënyrë që të evitohet kundërthëniet ekzistuese në mes dispozitivit me arsyetimin, arsyetimit me faktet vendimtare dhe me arsyet e theksuara për çështjet kruciale, e pas kësaj të merret vendim i ligjshëm dhe i drejtë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në vendim në bazë të nenit 195.1 nën pikën c) të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Ae.nr.383/2019, data 16.01.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

**Mahir Tutuli, d.v.**

